LIGJ
Nr.10 115, datë 23.4.2009

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE MINISTRISË SË EKONOMISË DHE FINANCAVE TË REPUBLIKËS GREKE E ORGANIZATËS SË SIGURIMIT TË KREDIVE TË EKSPORTIT (ECIO)"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni l

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave të Republikës Greke e Organizatës së Sigurimit të Kredive të Eksportit (ECIO)".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6156, datë 7.5.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MINISTRISË SË EKONOMISË DHE FINANCAVE TË REPUBLIKËS GREKE DHE ORGANIZATËS SË SIGURIMIT TË KREDISË SË EKSPORTIT

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë, këtu quhet "Pala Shqiptare" dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave të Republikës Greke së bashku me Organizatën për Sigurimin e Kredisë së Eksportit këtu quhet "Pala Greke", bien dakord për shlyerjen e borxhit që rrjedh nga marrëveshja ndërmjet Konsorciumit të Bankave Greke dhe Bankës Shtetërore të Shqipërisë, të nënshkruar në Athinë, më 24 qershor 1991, si më poshtë:

Neni 1

Borxhi total i Palës Shqiptare kundrejt Palës Greke arrin në 40 694 906,51 USD, i datës 30 prill 2008.

Neni 2

Periudha e shlyerjes së plotë i të gjithë borxhit është dhjetë (10) vjet dhe këstet përkatëse jepen në çdo gjashtë muaj.

Neni 3

Borxhi total duhet të paguhet në njëzet (20) këste të barabarta gjysmëvjeçare prej 2 034 745,32 USD secili. Kësti i parë i kërkueshëm më 31 tetor 2008 paguhet jo më vonë se 31 mars 2009, pa kamatëvonesë. Kështet e tjera për vitet 2009 deri 2017 bëhen të kërkueshëm dhe të pagueshëm më 30 prill dhe 31 tetor për çdo vit përkatës. Kësti i fundit është i kërkueshëm dhe i pagueshëm më 30 prill 2018. Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë i bën pagesat në llogarinë e veçantë në GR 1301000230000000002340396 "G.L.K. D25-Kefalaion Asfalisews Hrimatodotisewn ek Kafalaiwn i eggyisei toy ellinikoy Dimosioy" të Bankës së Greqisë, e hapur nga Pala Greke për këtë qëllim.

Neni 4

Interesi është i pagueshëm në fund të secilës prej 20 periudhave të njëpasnjëshme të interesit prej gjashtë muajsh secila. Llogaritja e interesit fillon më 1 maj 2008. Pagesa e parë e interesit bëhet jo më vonë se 31 mars 2009. Pagesat e tjera të interesit për vitet 2009 deri 2017 bëhen të kërkueshme dhe të pagueshme më 30 prill dhe 31 tetor për çdo vit përkatës. Pagesa e fundit e interesit është e kërkueshme dhe e pagueshme më 30 prill 2018.

Neni 5

Interesi llogaritet në fund të çdo periudha gjashtëmujore me një normë prej LIBOR gjashtëmujor mbi gjendjen e shumës kryesore të pashlyer. Norma e zbatueshme e interesit bazohet në Normën e Ofertës të London Interbank USD (USD LIBOR), dy ditë pune para fillimit të periudhës pasuese të interesit. Pala Greke njofton me shkrim Ministrinë e Financave të Shqipërisë në lidhje me shumën e saktë të çdo pagese të interesit jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para datës së kërkueshme. Për pagesën e parë Pala Greke njofton me shkrim Ministrinë e Financave të Shqipërisë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas nënshkrimit të Marrëveshjes.

Neni 6

Nëse një pagesë nuk bëhet në kohën e duhur, zbatohet kamatëvonesa. Kamatëvonesa llogaritet me normën prej dy për qind (2%) mbi normën e interesit të parashikuar në nenin 5. Shuma e kamatëvonesave llogaritet mbi shumën e pagesës së vonuar, për periudhën nga data e kërkueshme deri në datën në të cilën faktikisht bëhet pagesa.

Neni 7

Korrespondenca në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje është në gjuhën angleze dhe drejtohet si më poshtë:

a) Ministria e Ekonomisë dhe Financave e Republikës Greke, Zyra e Përgjithshme e Llogarive të Shtetit, Drejtoria e 25-të.

Adresa: Panepistimiou 37,
101 65 Athens
Greece
Tel nr:+302103338910/2103338972/2103338912
Faks nr:+302103338959

b) Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë
Adresa:Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" nr.1
Tirana, Albania
Tel:+3554222 8405
Faks:+3554222 8494

Neni 8

Palët bien dakord të zgjidhin, nëpërmjet konsultimeve, çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga kjo marrëveshje. Nëse mosmarrëveshja nuk zgjidhet, ajo zgjidhet ekskluzivisht nga gjykatat e Londrës dhe zbatohet ligji anglez.

Neni 9

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e ratifikimit të saj, sipas rregullave të brendshme të ligjit të secilës palë kontraktuese dhe mund të ndryshohet në mënyrë të efektshme vetëm me shkrim.

Bërë në Tiranë më…… në tre (3) kopje origjinale në shqip, greqisht dhe anglisht, ku të gjitha janë njëlloj autentike. Secila palë ka marrë një komplet kopjesh origjinale. Në rastin e mospërputhjes ndërmjet gjuhëve të ndryshme të versioneve të kësaj Marrëveshjeje, mbizotëron versioni në anglisht.

Për Ministrinë e Ekonomisë
dhe Financave të Republikës Greke
Ioannis Papathanasiou
Ministri i Ekonomisë dhe Financave

Për Organizatën e Sigurimit të Kredisë së Eksportit
Ioannis Pantelidis
Drejtor i Departamentit Ligjor

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë
Ridvan Bode
Ministri i Financave